

Në bazë të nenit 55 paragrafi 1 të Ligjit për organizimin dhe punën e organeve të administratës shtetërore („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 58/00, 44/02, 82/08, 167/10 dhe 51/11 dhe „Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 96/19 dhe 110/19), si dhe në bazë të nenit 22 dhe neni 25 të Ligjit për arsim të mesëm („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 44/1995, 24/1996, 34/1996, 35/1997, 82/1999, 29/2002, 40/2003, 42/2003, 67/2004, 55/2005, 113/2005, 35/2006, 30/2007, 49/2007, 81/2008, 92/2008, 33/2010, 116/2010, 156/2010, 18/2011, 42/2011, 51/2011, 6/2012, 100/2012, 24/2013, 41/2014, 116/2014, 135/2014, 10/2015, 98/2015, 145/2015, 30/2016, 127/2016, 67/2017 dhe 64/18) ministri i Arsimit dhe Shkencës e përcaktoi programin mësimor të shkurtuar për lëndën zgjedhore mësimore **Psikologjia për vitin IV (e katërt)** të fushave gjuhësore –humanistike dhe shoqërore – humanistike **në gjimnazin e mesëm** për vitin shkollor 2020/2021.



MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS  
BYROJA E ZHVILLIMIT TË ARSIMIT

PROGRAM MËSIMOR I SHKURTUAR

# PSIKOLOGJIA

VITI IV (i katërt)

gusht 2020

ARSIMI I MESËM - GJIMNAZ

## 1. HYRJE

Programi mësimor i shkurtuar, i lëndës **Psikologji**, bazohet në qëllimet/rezultatet e parashikuara në programin mësimor për lëndën mësimore që rregullisht realizohet sipas planit mësimor të përcaktuar.

Me programin e shkurtuar përcaktohen tema dhe njësi mësimore të caktuara që duhet të realizohen në 145 ditë mësimore, gjatë së cilës konsiderohet fondi i paraparë javor i orëve të përcaktuar në programin e rregullt, respektivisht për një lëndë mësimore me fond javor prej 2 orë, në programin e shkurtuar parashikohen 58 orë mësimore.

Mësuesi gjatë planifikimit dhe realizimit të njësive mësimore nga programi i shkurtuar, drejtohet kah qëllimet/rezultatet e parashikuara, nocionet e përcaktuara, metodat dhe aktivitetet e përcaktuara në programin e rregullt mësimor.

## 2. VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM I TEMAVE DHE NJËSIVE MËSIMORE

TEMA 1: HYRJE NË PSIKOLOGJI DHE METODAT E HULUMTIMIT ( 6 ORË)
---

<b>Njësité mësimore:</b>
--------------------------

- |   |
|---|
| <ul style="list-style-type: none"><li>• Lënda e psikologjisë dhe fushat e zbatimit të saj</li><li>• Zbatimi i psikologjisë në përditshmëri (ushtrime)</li><li>• Metodatat e hulumtimit në psikologji</li><li>• Dizajni i hulumtimit psikologjik (ushtrime)</li><li>• Treguesit themelor statistikor</li></ul> |
|---|

TEMA 2: BIOPSIKOLOGJIA ( 15 ORË)
----------------------------------

<b>Njësité mësimore:</b>
--------------------------

- |   |
|---|
| <ul style="list-style-type: none"><li>• Baza neuro-fiziologjike e jetës psikike</li></ul> |
|---|

- Nocioni *ndijimet* dhe llojet e ndijimeve
- Nocioni *perceptim* dhe karakteristikat e saj
- Ndikimi i faktorëve të brendshëm dhe të jashtëm gjatë perceptimit
- Zbatimi i njohurive për perceptim (ushtrime)
- Nocioni *vëmendje* dhe llojet e saj
- *Motivacioni* dhe llojet e motiveve
- Hierarkia e motiveve
- Nocioni dhe llojet e *emocioneve* dhe *ndjenjave*
- Shprehja dhe kontrollimi i emocioneve (ushtrime)
- Stresi (frustracionet dhe konfliktet)
- Reaksionet e frustracioneve dhe konflikteve
- Strategjitë e menaxhimit të stresit (ushtrime)

### TEMA 3: PSIKOLOGJIA KOGNITIVE ( 10 ORË)

#### Njësitë mësimore:

- Nocioni *të mësuarit* dhe llojet e saj
- Zbatimi i të mësuarit (ushtrime)
- Llojet dhe kuptimi i *kujtesës*
- Teknikat e përmirësimit të kujtesës
- Mjetet dhe rrjedha e aktivitetit të *të menduarit*
- Kreativiteti – strategji për zgjedhjen e problemeve
- Gjendjet e ndryshueshme të *vetëdijes*

### TEMA 4: ZHVILLIMI I JETËS PSIKIKE ( 9 ORË)

#### Njësitë mësimore :

- Shfaqja dhe zhvillimi i jetës psikike, zhvillimi filogjenetik dhe ontogjenetik
- Faktorët e zhvillimit psikik të njeriut

- Periudhat e zhvillimit
- Karakteristikat e periudhës së adoleshencës nëpërmjet vetvëzhgimit (ushtrime)
- Roli i prindërve, shkollës dhe moshatarëve në zhvillimin
- Ndikimi i teknologjisë në zhvillimin

#### TEMA 5: ASPEKTET SOCIO-KULTURORE TË ZHVILLIMIT ( 18 ORË)

##### Njësitë mësimore:

- Nocioni dhe karakteristikat e personalitetit
- Teorit e personalitetit
- Karakteri dhe temperamentit
- Vetvëzhgimi dhe analiza e karakterit dhe temperamentit personal (ushtrime)
- Aftësitë dhe inteligjenca
- Matja e inteligjencës (ushtrime)
- Zhvillimi i inteligjencës gjatë jetës
- Nocioni *normalitet*
- Shkaqet dhe llojet e çrregullimeve psikike
- Qasjet themelore në trajtimin e çrregullimeve psikike
- Dëshirat, qëndrimet dhe interesat
- Aspektet sociale dhe kulturore të sjelljes
- Konformizmi, altruizmi dhe agresioni
- Strategjitë për zgjidhjen e konflikteve (ushtrime)

### 3. REKOMANDIME DIDAKTIKE

Pikënisja për realizimin e programit të shkurtuar mësimor, të lëndës mësimore **Psikologji** për vitin **IV (e katërt)** të arsimit të mesëm - gjimnaz është programi i rregullt mësimor (qëllimet konkrete, udhëzimet didaktike dhe korrelacioni ndërmjet terrësive tematike dhe lëndëve). Gjatë realizimit të programit të shkurtuar mësimor, mësuesi duhet të ketë në konsideratë se ora mësimore zgjat 35 minuta. Në organizimin didaktik-metodik të këtyre orëve patjetër të kushtohet vëmendje e veçantë selektimit të përmbajtjes dhe ndarjes të nocioneve themelore dhe të rëndësishme psikologjike. Sipas kësaj, mësuesi duhet të nxisë që nxënësit të shprehin paranojë e tyre lidhur me nocionet të cilët i përpunojnë gjatë orës mësimore dhe mbi ta të përshtatin njohurit e reja. E nevojshme është që ora të fillojë me krijimin e një klime pozitive psikologjike për mësim nëpërmjet potencimit të rezultateve të pritura nga ora mësimore dhe në këtë mënyrë do të kemi rritje të vëmendjes dhe gadishmërisë së nxënësit për punë. Gjatë orës mësimore, mësuesi paraqet fakte, i sjell ato në marrëdhënie të ndërsjellta, bën lidhshmërinë me materien e mësuar më parë duke filluar nga e njohura drejt të panjohurës, nga e thejshta tek e ndërlikuara. Mësimi duhet të jetë i orientuar drejt pjesëmarrjes aktive të nxënësve, të nxitet dhe zhvillohet pavarësia e tyre, të menduarit, qëndrimi kritik dhe hulumtimi.

Mësuesi duhet të ketë parasysh se disa njësi mësimore në programin e shkurtuar janë lënë anësh, deri sa disa të tjera janë bashkangjitur. Kështu që, nga tërësia e pare tematike është reduktuar njësia mësimore për etikë në hulumtimet psikologjike. Rekomandohet që mësuesi në kornizë të njësisë mësimore për metodat e hulumtimit, të drejtojë dhe me shembuj të tregojë për rëndësinë e etikës në hulumtimet psikologjike. Në temën e dytë, rekomandohet që të mos futet në detaje për bazën neurofiziologjike të jetës psikike (funksioni i Sistemit Nervor Qendror, sistemi vegjetativ dhe sistemi endokrin) sepse këto njohuri përveçohen në lëndën e Biologjisë. Për ndikimin e rrethit dhe trashëgimisë në zhvillimin është paraparë të mësohet vetëm në një segment dhe atë në temën katër. Në temën pesë, është e reduktuar mësimi i nocioneve paragjykimet dhe stereotipet, për shkak se nxënësit kanë paranojë për këto nocione nga lënda Sociologji.

Mësuesi duhet të përdorë metoda aktive të mësimdhënies si dhe veprime me të cilët në mënyrë më efektive do të arrijë qëllimin e programit mësimor, derisa të njejtat do të përshtaten me nevojat dhe mundësitë e vetë nxënësve. Mësuesi do t'i nxisë nxënësit që të zbatojnë atë që është mësuar në jetën e përditshme dhe nëpërmjet analizës së sjelljes së vet të njohin veten e tyre.

Gjatë realizimit të programit të shkurtuar, mësuesi do të nxisë të mësuarot aktiv nëpërmjet përdorimit të teknologjisë, të mësuarit nëpërmjet proekteve, të mësuarit kooperativ e cila e rrit motivacionin për të mësuar tek nxënësit si dhe dëshirën për hulumtim dhe pavarësi gjatë përvetësimit të njohurive të reja.

#### 4. **NORMATIVI PËR KUADRIN MËSIMOR**

Programin e shkurtuar mësimor e realizon mësimdhënësi në përputhje me normativin për kuadër mësimor të dhënë në programin e rregullt mësimor.

Programin e shkurtuar mësimor për lëndën **Psikologjia për vitin IV (e katërt)** të arsimit të mesëm - gjimnaz, e miratoi

Ministri i Arsimit dhe Shkencës

Milla Carovska